

LIGJ
Nr. 83/2017

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2012, PËR PROJEKTIN “PROGRAMI
I INFRASTRUKTURËS KOMUNALE IV”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2012, për projektin “Programi i infrastrukturës komunale IV”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.5.2017

Shpallur me dekreten nr. 10337, datë 18.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2012 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS KOMUNALE IV”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë – në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë,

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 25 shtator 2012 – kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose një marrësi tjetër, që do të zgjidhet bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumat e mëposhtme:

1) një hua me kushte të favorshme për projektin “Infrastruktura komunale IV Program”, e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vlefte prej deri në 20 000 000 EUR (me fjalë: njëzet milion euro), nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera;

2) një shumë financimi me vlefte prej deri në 2 000 000 Euro (me fjalë: dy milion euro) për masën e nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit “Infrastruktura komunale IV Program”.

2. Projekti i përmendur në paragrafin 1 pikë 2 mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë bien dakord.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga KfW hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 1 pikë 2 do të kthehen në hua, nëse nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis KfW-së dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, kontrata të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1 zhvleftehet, kur kontratat përkatëse për hua dhe për financim nuk lidhen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimeve. Për shumat e përmendura, afati mbaron më datë 31 dhjetor 2020.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj KfW-së të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai nuk është vetë marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj KfW-së pretendime eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2 paragraf 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, që rezulton nga dhënia e huave dhe të shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, në të cilën Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më datë në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës
Federale të Gjermanisë